

V E N D I M
Nr.87, datë 18.2.1999

PËR MIRATIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR SHITESËN E FONDIT GRANT PREJ 2 450 000 DM PËR VAZHDIMIN E PROJEKTIT "MBËSHTETJE E UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për shtesën e fondit grant prej 2 450 000 (dy milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) DM, për vazhdimin e projektit "Mbështetje e Universitetit Bujqësor të Tiranës".

2. Ngarkohet Universiteti Bujqësor i Tiranës të përballojë detyrimet fiskale dhe tatimore që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për të kryer shkëmbimin e notave për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës për zbatimin e këtij projekti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko